



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:282859
Datë: 07.10.2024
Numri i dokumentit: 06260417

A.nr.2151/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Lirije Maksutaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Erbleta Shala, në konfliktin administrativ të paditëses F.. K.. nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson av. Rinor Kastrati, me adresë në rr. “Agim Ramadani”, hy. 32, kati II, nr.8-Prishtinë, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transferove-Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit për -njohja e të drejtës në pensionin me pa aftësi të përhershme si kompensimin e pensioneve te pa paguara, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 18.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses F.. K.. ndërsa ANULOHET vendimi i të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me nr.5033295 të datës 11.07.2019, dhe vendimi i shkallës së parë i datës 24.04.2019, dhe paditëses i njihet e drejta në Pension për persona me aftësi të kufizuar në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh dhe atë nga data e nxjerrjes së ekspertizës financiare dt.30.07.2024 e deri me 30.07.2029.

II. DETYROHET e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale, që paditëses në mënyrë retroaktive t’ia kompensoj pagesat e papaguara për Pensionin për Persona me Aftësi të Kufizuar që nga dita e kërkesës/ aplikimit të këtij pensioni datë 11.02.2019, deri më 30.07.2024 dhe atë në shumën e përgjithshme të pensioneve mujore dhe shtesave në vlerën prej 6,373.06 € (gjashtë mijë e treqind e shtatë dhjetë e tri euro e 6 cent), 6 si dhe kamatën prej 8% sipas LMD-së deri në pagesën definitive, krejt këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nën pasojat e përmbarimit me detyrim.

IV. UDHËZOHET paditësja që para datës 30.07.2029 të paraqes kërkesë për rivlerësim mjekësor tek e paditura, për t'i vazhduar njohjen e kësaj të drejtë.

V. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.

A r s y e t i m

Seanca e shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të autorizuarit të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt, si dhe në prezencën të ekspertit financiar .

Paditësja në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 13.09.2019, ka deklaruar se “e paditura e ka refuzuar kërkesën në kundërshtim me gjendjen faktike duke mos e pasur parasysh faktin se te paditësja aftësinë e dëgjimit e ka në shkallë të rënd dhe se dëgjimi i saj është plotësisht i dëmtuar. Paditësja për dhjetë vite ka qenë përfituese e këtij pensioni dhe se nuk qëndron pretendimi i të paditurës se paditësja nuk ka mundur të dëshmojë që ka aftësi të kufizuar. E paditura nuk i ka aplikuar drejt dispozitat ligjore për faktin se paditësja është persona me aftësi të kufizuar. Kërkon nga gjykata që ti aprovohet kërkesëpadija e paditëses në tërësi si e drejtë dhe e bazuar, të anulohet aktvendimi refuzues i organit të shkallës së dytë me nr.5033295 të datës 11.07.2019, si dhe të obligohet e paditura që paditëses F. K. nga P., t’ia njohë të drejtën në pension për pa aftësi të përhershme, nga dita e kërkesës/ aplikimit të këtij pensioni, meqë i plotëson kushtet ligjore nga Ligji 04/L-131, për Pension të Personave me pa aftësi të përhershme në Kosovë”. Sa i përket ekspertizës financiare nuk kemi vërejtje në ekspertizë dhe nuk kemi nevojë për sqarime plotësuese. Meqenëse në këtë çështje administrative janë nxjerr edhe dy ekspertiza ajo mjekësore dhe kjo financiare në këtë seance në forme të parashtrësës dorëzoj precizimin objektiv të kërkesëpadiësë e po ashtu me parashtrësë është edhe përmirësimi i një gabimi teknik ku mbiemri i paditëses nuk duhet të jetë Koshtova por është Koshutova”.

E paditura me përgjigjen në padi të parashtruar në gjykatë me datën 29.07.2021, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadiinë e paditëses, duke theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform dispozitave të nenit 3 të Ligjit nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar, dhe nenit 9, paragrafit 5 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ajo

në të cilën pretendon pala, se ky vendim është marrë me shkelje ligjore, nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në bazë të konstatimit të komisionit të mjekëve të fushave përkatëse, të dokumentacionit mjekësor dhe vlerësimit të komisionit mjekësorë të shkallës së dytë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar me prova. Andaj, duke u bazuar në thëniet e cekura më lartë, e paditura i propozon gjykatës që pas administrimit të provave, të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses F.. K.. nga P., duke lënë në fuqi vendimin me nr.5033295 të datës 11.07.2019.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 18.09.2024, ka administruar provat relevante: kërkesa e dt.11.02.2019, kërkesa për pension të paaftësisë, certifikata e mjekut e dt.07.02.2019, raporte mjekësore për paditësen , vendim i dt.24.04.20219, ankesë e dt.06.06.2019, vendim i dt.25.08.2004, vendim i dt.12.04.2007, vendimi i dt.11.07.2019, vendimi i dt.01.01.2009, vlerësimi i komisionit mjekësore i dt.12.04.2012, shqyrtimi i ankesës i dt.12.07.2019, ekspertiza mjekësore e dt.21.05.2024, ekspertiza financiare e dt.30.07.2024, parashtrere e precizimit dt.18.09.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 dhe 67 të Ligjit për Konflikte Administrative ashtu që vendosi që vetë meritorisht ta vendosë këtë çështje administrative. Gjykata duke vlerësuar vendimin e goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thëniet e padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ajo përmbajnë të meta, për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47.1.3, dhe nenin 48 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj.

Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar, respektivisht, në nenin 48 parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit, ndërsa, nëse është i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës, apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Vendimi i të paditurës, është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar në marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit kontestues është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt, ku ndër të tjera thuhet se: *“këshilli i ankesave si organ i shkallës së dytë me ekspert mjekësor të lëmisë përkatëse duke vepruar sipas ankesës së z/znj F.. K.. nga P., ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e dt.01.07.2019, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësorë që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit të shkallës së parë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 për PAK, dhe ka konstatuar- vlerësuar se nuk ka dokumentacion mjekësorë të mjaftueshëm për të qenë përfitues i Pensionit për Persona me pa aftësi të përhershme, prandaj Komisioni mjekësor i shkallës së dytë, pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj. Organi i shkallës së parë ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar në plotëni dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative dhe etikën mjekësore dhe se ka konstatuar se parashtruesi i ankesës nuk i përmbushë kriteret e parashikuara me paragrafin 5 të nenit 9 të Ligjit 04/L-131,”.*

Duke ju referuar propozimit të paditëses, gjykata me aktvendimin A.nr.2151/2019 të datës 07.10.2022 , e me qëllim të marrjes së ekspertizës relevante mjekësore për të cilën gjykata nuk ka njohuri profesionale, kishte caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore përmes së cilës ekspertët përkatës mjekësor, pas ekzaminimit fizik mjekësor dhe shqyrtimit të raporteve mjekësore, do të përcaktonin nëse paditësja është person me pa aftësi të përhershme, për kryerjen e kësaj ekspertize ka caktuar mjekë specialist, Dr.K.. K..-O..etj..

Gjykata po ashtu, me qëllim që të përcaktohet vlera e saktë e kompensimit e cila duhet të paguhet nga dita e kërkesës/ aplikimit se këtij pensioni, me kërkesën e palës paditëse me aktvendimin

A.nr.2151/2019 të datës 07.02.2024, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare e cila i është besuar Ekspertes Financiare H.. Z..

Me datën 21.05.2024, ekspertet mjekësor kanë përpiluar Raportin e Ekspertizës Mjekësore të dorëzuar në gjykatë, dhe gjykata po ashtu ka ftuar ekspertet mjekësor të deklarohen lidhur me ekspertizën në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Kjo gjykatë pas administrimit të provave si më lart pasi që i vlerësoi me kujdes secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, i falë besimin raporteve të administruara në seancë, me të cilat konstatohet se si paditësja është e paaftë për punë dhe gjendja, sëmundja apo aftësia e kufizuar është e përhershme. Në veçanti, Gjykata krijoi bindjen e saj nga ekspertiza e nxjerrë nga grupi i ekspertëve e datës 21.05.2024, në të cilën ekspertët kanë arritur në përfundim, së në bazë të dhënave anamnestike dhe ORL ekzaminimit, shqyrtimit të dokumentacionin mjekësor konkludojm se; “pacientja ka dobësim dëgjimi të shkallës së rënd në të gjitha frekuencat në të dy veshët. Dobësimi i dëgjimit ka shkaktuar edhe mos aftësinë e zhvillimit të folurit si dhe interaksionet sociale të cilat pengojnë pacientin në kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore, punuese edhe në aspektin e komunikimit. Dëmtimi i dëgjimit është i përhershëm”.

Nga shkresat e lëndës shihet dhe vërtetohet se gjendja e saj shëndetësore nuk ka ndryshuar, dhe këtë fakt e vërtetoi edhe ekspertiza e eksperteve mjekësor e 21.05.2024. Për të gjitha këto arsye, kjo gjykatë nuk mundi t’i falë besimin mendimit dhe konstatimit të komisionit mjekësor të së paditurës të dhënë në vendimin e datës 11.07.2019, si provë e vetme e që vërteton se paaftësia e përhershme e kufizuar të paditësja nuk ekziston. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë ka vlerësuar dhe vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 9 paragrafët 1 dhe 5 te Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është përcaktuar që *“Pensioni i paaftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës”*; *“Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5)*

vitesh; Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nenin paragrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.”

Po ashtu sipas nenit 9, paragrafit 5, nën-paragrafi 2, të Ligjit Nr. Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në lidhje me nenin 3 të Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, është përcaktuar që Komisioni Mjekësorë vlerëson nëse ekziston apo jo paaftësia e përhershme e punës. Nga kjo rrjedh se, e rëndësisë partikulare që një personi t'i njihet e drejta në pension të personave me aftësi të kufizuar, ashtu që të konstatohet nëse ekziston apo jo paaftësia e përhershme e punës.

Ndërsa me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ është paraparë që “Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”. Po ashtu e paditura me vendimi e atakuar i'a ka mohuar paditëses të drejtën për shfrytëzimin e pensionit me paaftësi të përhershme nga dita e kërkesës/aplikimit të këtij pensioni të personave me paaftësi të përhershme datë 11.02.2019. Nga kjo rezulton se paditësja në momentin e ekzekutimit të vendimit kontestues i është shkaktuar dëm ngase e njëjta nuk ka mundur të realizoj të ardhurat që kanë buruar nga e drejta në shfrytëzimin e pensionit të personave me paaftësi të përhershme, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Prandaj për faktin se paditësja ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata, kërkesëpadinë e saj e aprovoi si të bazuar dhe si rrjedhojë e detyroi të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqë vlerësoi se sa i përket mendimeve dhe vlerësimit të eksperteve, është e çartë, si dhe e paditura nuk e ka kontestuar, nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, madje e paditura nuk i është përgjigjur as ftesave për seancën e shqyrtimit kryesor.

Kjo gjykatë vlerësoj dhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, të njëjtat pretendime i vlerëson si të pa bazuara, nga fakti se nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor është vërtetuar se paditësja i plotëson kërkesat e ligjit për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Lidhur me lartësinë e pensionit, gjykata u bazua në vlerën e caktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/176, të dt.10.03.2014, ku lartësia e këtij pensioni është ngritur

në shumë prej 75 euro për muaj ndërsa në bazë të ndihmës mujore nga shteti prej muajit shkurt 2022 nga 100 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, 5 lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 63 e lidhur me nenin 21 Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin Ligjit, Nr.03/L-006 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2151/19, datë: 18.09.2024

Gj y q t a r e
Lirije Maksutaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.